



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA  
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPJANIT  
OPSHTINA LIPLJAN  
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në bazë të nenit 12 paragrafi 12.2 dhe 68 paragrafi 68.4, të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr. 28 e datës 4 qershor 2008, nenit 11,13 të Ligjit nr.04/L-174 për Planifikimin hapësinor ,nenit 7 paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.05/2014 (MMPH) për përgjegjësitë e autoriteteve të planifikimit hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor si dhe parimet dhe procedurat për pjesëmarrjen e publikut në planifikimin hapësinor, nenit 13 të Udhëzimit Administrativ (MAPL) nr.04/2018 për transparencë në Komuna, Udhëzimit administrativ (MAPL) nr.06/2018 për standardet minimale të konsultimit publik në Komuna, nenit 20 paragrafi.1 dhe 64 të Statutit të Komunës së Lipjanit, 1Nr.110-623 të datës 26.09.2008 nenit 11 të Rregullores mbi transparencën në Komunën e Lipjanit 15Nr.000-79233 e datës 20.12.2019 , Planit të Veprimit për transparencë në Komunë, Vendimit për hartimin e hartës zonale të Komunës 15Nr.011-41550 e datës 01.07.2017, Njoftimit të Ministrisë së Ekonomisë dhe Ambientit nr.2484-2/20 e datës 10.07.2020, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e datës 30.07.2020, pas shqyrtimit të propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës miratojë këtë:

## VENDIM

### PËR VËNIEN NË SHQYRTIM PUBLIK TË PROJEKT-DOKUMENTIT TË HARTËS ZONALE TË KOMUNËS SË LIPJANIT 2020-2028

#### Neni 1

Me këtë Vendim, vëhet në shqyrtim publik Projekti-dokumenti : Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028.

#### Neni 2

1. Projekt- Dokumenti nga pika 1 e këtij vendimi do te publikohet ne web faqen zyrtare të Komunes <http://kk.rks-gov.net /lipjan>
2. Shqyrtimi publik zgjat 30 ditë dhe fillon nga dita e hyrjes në fuqi të këtij Vendimi

3. Propozimet , sygjerimet apo vërejtjet eventuale paraqiten në formë të shkruar gjate kohëzgjatjes se shqyrtimit publik për Drejtoratin për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit përmes Qendres për shërbimin e qytetarëve: Ndërtesa e Administratës Komunale si dhe ne formë elektronike: [dpumm.lipjan@rks-gov.net](mailto:dpumm.lipjan@rks-gov.net) .

4. Pas përfundimit të shqyrtimit publik të dokumentit nga pika 1 e këtij Vendimi, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit si autoritet menaxhues i procesit do të kryejë

veprimet e parapara ligjore për finalizimin e këtij dokumenti, në mënyrë që ai t'i prezantohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim përfundimtar.

### Neni 3

Pjesë përbërëse e këtij Vendimi është dokumenti-Harta Zonale e Komunës së Lipjanit 2020-2028.

### Neni 4

Për zbatimin e këtij Vendimi do të kujdeset Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit dhe Sektori për marrëdhënie me publikun.

### Neni 5

Vendimi hyn në fuqi 7 ditë pas publikimit në faqen zyrtare të Komunës.

Nr.15- 350-32607

Lipjan, më 30. 07. 2020

## KUVENDI I KOMUNËS LIPJAN

Kryesuesi i Kuvendit

Daut Azemi

